



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR VLORË**

---

<b>Numri i Ceshtjes :</b>	58339-00562-61-2018	<b>Data e Regjistrimit :</b>	01/03/2018
<b>Numri i Vendimit:</b>	61-2018-3536	<b>Data e Vendimit :</b>	11/06/2018

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR VLORË E PËRBËRË NGA:**

**GJYQTAR:** Vjola Canaj

**SEKRETARE:** Lefteri Spaho

Sot më datë 11/06/2018 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen penale që i përket :

**Të pandehurit:** xxxx, i biri i xxx, i datëlindjes xxx

**Akuzuar:** Gjykim i procedimit penal nr, xxx ne ngarkim te te pandehures Xakuzuar per vepren penale te parashikuar nga neni 287/1 germa d te K Penal

XXXXXXXXXXXXXXXXXX

**VEREN :**

Vëren:

**GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR**

**VLORE**

**Nr. 272 Regj.Them**

**Date 01.03.2018**

**Date 1**

**V E N D I M**

**“NE EMER TE REPUBLIKES”**

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Vlore, e perbere prej

**Gjyqtare**

**Vjola Canaj**

asistuar prej sekretares se seances Lefteri Spahaj, sot me date 11.06.2018, mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore me dyer te hapura, kerkesen penale qe i perket:

**Kerkues:** Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Vlore

**E pandehur:** xxxx, e bija e Vladimir dhe e Ana, e datelindjes

xxxx, lindur ne Vlore dhe banuese ne Vlore, me adrese lagjja "xxx", prane xxxx dhe me adrese aktuale xxxxx, me arsim tete klase, e padenuar me pare, me shtetesi shqiptare, me gjendje civile e martuar, e hetuar ne gjendje te lire, mbrojtur nga av. xxxx, anetar I Dhomes se Avokatise Vlore.

**Akuza**

"Pastrimi i produkteve

parashikuar nga neni 287/1 germa "d" te Kodit Penal.

i Kodit Penal.

**PANDEHURI: Ne perfundim te çeshtjes, palet pretenduan:**

**Prokuroria:**

1. Deklarimin fajtor te te pandehures **xxxxxx**, per kryerjen e vepres penale "Pastrim produkteve te vepres penale ose veprimtarise kriminale", te parashikuar nga neni 287/1 germa "d"te Kodit Penal dhe denimin e saj me 5 (pese) vite burgim.

2. Ne baze te neneve 190.1 germa "a" te K.Pr. Penale dhe nenit 36.b te Kodit Penal, te konfisko dhe te kalojne ne favor te shtetit, produktet e vepres penale mbi te cilat me vendimin gjyqesore nrxxxxx te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore eshte vendosur masa e sigurimit pasuror e sekuestros preventive, e konkretisht te:

a) Apartament banimi me numer pasurie xxxx, me siperfaqe 112 meter katrore, i cili eshte regjistruar ne regjistrin hipotekor nr. xxxx, apartament i blere nga shtetasja Xpermes kontrates se shitjes nr. xxxx kol, date 28.12.2013.

b) Apartamenti nr. xxx, ne katin e shtate banimi, me siperfaqe 86.2 meter katrore, i cili ndodhet ne objektin godine banimi 12 kateshe, me nje kat parkim nentoke, ne lagjen "xxxx" (xxxxx), i ndertuar mbi bazen e lejes se ndertimit nr. xxxx te KRRT-se

prane xxx, te ndertuar nga subjekti "xxxx" sh.p.k, apartament i cili eshte blere nga shtetasja xxxx permes kontrates se shitblerjes se sendit te ardhshem nr. xxxx kol, date xxxx.

c) Apartamenti nr. 35, ne katin e shtate banimi, me siperfaqe 70.97 meter katrore, i cili ndodhet ne objektin godine banimi 12 kateshe, me nje kat parkim nentoke, ne lagjen "xxxx" xxxxx, i ndertuar mbi bazen e lejes se ndertimit nr. xxx te KRRT-se

prane Bashkise Vlore, te ndertuar nga subjekti "xxx" sh.p.k, apartament i cili eshte blere nga shtetasja xxxx permes kontrates se shitblerjes se sendit te ardhshem nr. xxx kol, date 10.06.2015.

date 10.06.2015.

3. Shpenzimet proceduriale te kryera gjate hetimit paraprak ne shumen prej 56 000 (pesedhete e gjashtemije) leke si dhe ato te kryera gjate gjykimit, t'i ngarkohen te pandehures xxxxx.

**Mbrojtja e te pandehures xxxx:** Deklarimin e pafajshem te te pandehures.

**- E pandehura:** E paparaqitur.

Gjykata si degjoi palet si dhe shqyrtoi aktet ne teresi,

### **VEREN**

Se, Prokuroria prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore ka paraqitur prane kesaj gjykate kerkesen per gjykimin e te pandehurit xxxx, i akuzuar per kryerjen e vepres penale "Pastrimi i produkteve te vepres penale ose veprimtarise kriminale" te parashikuar nga neni 287/1 germa "d"te Kodit Penal.

Gjykata çmon aktet dhe provat e paraqitura nga prokuroria dhe ato nga mb  
pandehures, ne perfundim rezultuan keto rrethane fakti:

Keshtu, me date 22.08.2013, e pandehura Xka porositur tre apartamente ne shumen 155.805 euro, prane subjektit "xxxx" sh.p.k. Ky veprim juridik eshte konkretizuar ne kontraten e siper marrjes per prenotim apartamenti nr. xxxx rep, date 22.08.2013. Objekti i kesaj kontrate eshte prenotimi i tre apartamenteve ne objektin "xxx", nje godine xxxx-xxx kate, me nje kat parkim nen toke, ne lagjen "xxx", Vlore, sipas lejes se ndertimit nr.xxxxx. Konkretisht apartamenti nr.xxxx, kati xx nga toka, me siperfaqe 126.1 meter katror dhe me vlere 59.267 euro, apartamenti nr. xxx, kati i xxxe nga toka, me siperfaqe 98.7 m2 dhe me vlere 46.389 euro, si dhe apartamenti nr. 5, kati i tete nga toka, me siperfaqe 106.7 meter katrore dhe me vlere 50.149 euro. Ne lidhje me menyren e pageses eshte parashikuar se kesti i pare prej 20.000 euro eshte likuiduar, kesti i dyte prej 30.000 Euro do te likuidohet deri ne dhjetor te vitit 2013, kesti i trete prej 30.000 Euro do te likuidohet deri ne muajin mars te vitit 2014 dhe kesti i katert prej 75.805 Euro, do te likujdohet deri ne 21.06.2014.

E pandehura xxxxx, permes kontrates se shitjes nr. xxxxxxxx, ka blere nga subjekti "xxxx" sh.p.k, nje apartament banimi ne shumen prej 3.735.144 leke. Konkretisht rezulton se eshte blere pasuria nr. xxx, me siperfaqe 112 meter katrore, e cila eshte regjistruar ne regjistrin hipotekor nr. xxxx. Rezulton se shuma e çmimit te kesaj kontrate eshte likuiduar nga palet jashte zyres se noterise.

Nga deklarimet e shtetasit xxxx, rezulton se e pandehura Xka blere nga subjekti "xxx" sh.p.k, vetem apartamentin e mesiperm, ndersa dy apartamentet e tjera te cituara ne kontraten e siper marrjes per prenotim, nuk jane blere nga e pandehura xxxx, per faktin se nuk ka paguar detyrimet sipas kontrates.

Provohet se me date 30.12.2013, e pandehura xxx, ka derdhur ne llogarine e saj bankare shumen prej 25.000 Euro dhe po ne kete date ka derdhur ne llogarine bankare te shtetases xxx shumen prej 20.000 Euro.

Ndersa nga verifikimet ne lidhje me shtetasen xxx, e cila eshte nena e te pandehures x, rezulton se me date 21.06.2013, ka lidhur nje kontrate per prenotimin e tre apartamenteve ne shumen 155.805 Euro, me subjektin "xx" sh.p.k. Kjo kontrate eshte revokuar permes veprimit juridik Revokim Kontrate nr. xxxxx. Nga kjo kontrate rezulton se behet fjale per te njejtat apartamente per te cilat e pandehura xxx, me date

22.08.2013, ka porositur prane subjektit "xxx" sh.p.k.

Shtetasja xxxx, permes kontrates se shitblerjes se sendit te ardhshem nr. xxxx kol, date 10.06.2015, ka blere nga subjekti "xxxxxxxxx" sh.p.k, dy apartamente banimi. Konkretisht apartamenti nr. xx ne katin e shtate banimi, me siperfaqe 86.2 m2 dhe me çmim 34.500 euro, si dhe

apartamenti nr. xx, ne katin e shtate banimi, me siperfaqe 70.97 meter katrore dhe me çmim 26.000 Euro. Apartementet ndodhen ne objektin godine banimi 12 kateshe, me nje kat parkim nentoke, ne lagjen "xxx), i ndertuar mbi bazen e lejes se ndertimit nr. 3.87, date 07.06.2010 te KRRT-se prane Bashkise Vlore, te ndertuar nga subjekti "xxx" sh.p.k. Rezulton se kesti i pare prej 5.000 Euro per apartamentin nr. xxx eshte likuiduar permes llogarise se noteres prane xx, ndersa pjesa vijuese e çmimit eshte pranuar te likuidohet ne keste vijuese, per çdo muaj ne shumen prej 2500 Euro dhe kesti i fundit ne shumen prej 1500 Euro do te likuidohet kur palet te lidhin kontraten e shit-blerjes. Ndersa kesti i pare prej 13.000 Euro, per apartamentin nr. xxxxx eshte likuiduar permes llogarise se noteres prane xxxxxx, kurse pjesa vijuese e çmimit eshte pranuar te likuidohet ne keste vijuese, per çdo muaj ne shumen prej 1000 Euro dhe kesti i fundit ne shumen prej 1500 Euro do te likuidohet kur palet te lidhin kontraten e shit-blerjes. Ne kete kontrate eshte pershkruar fakti se çmimi i shitblerjes se ketyre pasurive perfaqesohet nga vlera perfaqesimi te dy vajzave te saj, te ndodhura ne Belgjike, te quajtura xxxxx dhe xxxxxxx, ndersa bleresja ne kete kontrate ka deklaruar se nuk ka aftesi paguese. Nga deklarimet e shtetasit xxxxxxxx dhe dokumentet e administruara prane ketij shtetasi, rezulton se shtetasja xxxxxxxxxxxx, ka paguar te gjithë çmimin per blerjen e ketyre dy apartamenteve. Me date 22.08.2013, shtetasja xxxxxxxxxxxx, ka derdhur ne banke shumen prej 10.000 euro.

Po keshtu, me date 01.04.2015, ne llogarine e shtetases xxxxxx eshte arketuar shuma prej 14.695 Euro, e cila eshte derguar nga shtetasi xxxxx. Me date 14.04.2015, shtetasja Ana Roçaj ka perfituar shumen prej 12.965 Euro, nga shtetasi xxxxxxxx, me pershkrimin "blerje shtepie". Me date 03.05.2016, ka perfituar shumen prej 3000 Euro nga shtetasi xxxxxxxx, me pershkrimin "pagese per apartament". Me date 19.11.2015, shtetasja xxxxxxxxxxxxxxxx ka terhequr shumen prej 14.102 Euro. Ndersa shtetasi xxxxxxxxxxxx rezulton se ka ne proces legalizimi nje ndertese nje kateshe me siperfaqe 76.5 meter katrore dhe siperfaqe trualli 579 meter katrore, qe ndodhet ne lagjen "xxxxxxxx", xxxxx

Nga Drejtoria Rajonale Tatimore Vlore rezulton se e pandehura Xdhe f saj, nuk jane te regjistruar si tatimpagues. Ndersa referuar te dhenave te administruara prane Drejtorise se Pergjithshme te Doganave rezulton se e pandehura Xdhe familjaret e saj, nuk kane deklarime cash, çek apo metale e sende te çmuara ne pikat e kalimit kufitar per periudhen mars 2014-30 prill 2016. Nga te dhenat e administruara prane Sherbimit Kombetar te Punesimit, Drejtoria Rajonale Vlore, rezulton se e pandehura Xdhe familjaret e saj, nuk figurojne si punekerkues.

Nga te dhenat e administruara nga prokuroria ka rezultuar se shtetasi xxxxxxxxxxxx eshte identifikuar se shtetasi xxxxxxxxxxxx, i datelindjes xxxxxxxxxxxx me shtetesi xxxxxxxx. Me date 30.03.2015, llogaria bankare e ketij shtetasi eshte kredituar me nje transferte ne shumen 51.132 Euro nga nje noter ne xxxxxxxxe, me pershkrimin "xxxxxxxxxx". Rezulton se ne te njejten date eshte transferuar shuma prej 28.200 Euro ne nje llogari te pandehures xxxx. Po ne kete date eshte transferuar shuma prej 15.000 Euro ne llogarine bankare te shtetases xxxx. Me date 07.04.2015, shtetasi xxxxxxxx ka kryer tre depozita cash ne llogarine e tij ne xxxxxx ne shumen totale prej 13.000 Euro dhe po ne te njejten dite kjo shume eshte transferuar ne llogarine e shtetases xxxxxxxx. Rezulton se shtetasi xxxxxxxxxxxx eshte drejtor i subjektit tregtar "xxxxxxxxxx", si dhe ka qene drejtor i biznesit "xxxxxxxxxxxxx" deri me date 13.05.2013. Ndersa e pandehura Xrezulton se eshte e martuar me shtetasen xxxxxxxx, e datelindjes 24.05.1967. E Pandehura Xdhe shtetasja xxxx jane menaxhere te biznesit "xxxxxxxxx, subjekt i cili ushtron aktivitetin e tij ne xxx.

Gjithashtu rezulton se e pandehura Xeshte menaxhere e biznesit xxxx, subjekt i

cili ushtron aktivitetin e tij ne xxxxxxx.

Nga autoriteteti gjyqesore i xxxxxx eshte derguar permes leterporosise, se ne xxxxx ka pasur nje hetim penal ne ngarkim te shtetasve xxx, xxxxx, per vepren penale te shfrytezimit te prostitucionit. Rezulton se e pandehura Xdhe shtetasi xxxx, kane perfituar te pakten 487 899 euro nga shfrytezimi i dy bareve ku ushtrohej prostitucion. Nga keto te dhena rezulton se e pandehura xxxx, ka ushtruar aktivitet kriminal ne fushen e shfrytezimit te prostitucionit ne xxxx, ku nga kjo veprimtari kriminale ka perfituar te pakten shumen prej 487 899 euro. Gjithashtu rezulton se e pandehura nje pjese te ketyre parave te perfituara nga veprimtaria kriminale i ka investuar ne territorin e Republikes se Shqiperise, duke blere pasuri te paluajtshme.

Per sa me siper, gjykata çmon se provohet tej çdo dyshimi te arsyeshem se e pandehura Xka kryer vepren penale “Pastrimi i produkteve te vepres penale ose veprimtarise kriminale”, parashikuar nga neni 287/1 germa “d” te Kodit Penal.

Mbrojtja e te pandehures Xu shpreh per deklarimin e pafajshme te te pandehures me arsyetimin se nuk eshte ajo autore e kesaj vepre dhe paraqitet disa akte ne gjuhe te huaj e te noterizuara ne cilesine e provave shkresore. Gjukata i pranoi marrjen e tyre, per te mos paragjykuar, por ne kushtet ku keto prova nuk rezultonin te marra ne menyren qe parashikon Kodi i Procedures Penale, gjykata çmon se ato nuk mund te perdoren ne favor apo disfavor te pales qe i ka kerkuar.

Gjukata konstaton se nga te dhenat e mesiperme rezulton se pasuria e paluajtshme e perfituar nga e pandehura Xdhe shtetasja zxxxx, e cila eshte nena e te pandehures, ka si origjine te ardhurat e periftuara nga e pandehura xxx, nga aktiviteti kriminal i ushtruar ne fushen e shfrytezimit te prostitucionit ne xxx. Konkretisht rezulton se eshte perfituar apartament banimi me numer pasurie xxxxxx, me siperfaqe 112 meter katrore, i cili eshte regjistruar ne regjistrin hipotekor nr. xxxxx, apartament i blere nga e pandehura Xpermes kontrates se shitjes nr. xxxxx. Rezulton se eshte perfituar apartamenti nr. xxx, ne katin e shtate banimi, me siperfaqe 86.2 meter katrore, i cili ndodhet ne objektin godine banimi 12 kateshe, me nje kat parkim nentoke, ne lagjen “xxxxx, i ndertuar mbi bazen e lejes se ndertimit nr. 3.87, date 07.06.2010 te KRRT-se prane Bashkise Vlore, te ndertuar nga subjekti “xxx” sh.p.k, apartament i cili eshte blere nga shtetasja xx permes kontrates se shitblerjes se sendit te ardhshem nr. xxxxxx. Gjithashtu rezulton se eshte perfituar partamenti nrxxxxx ne katin e shtate banimi, me siperfaqe 70.97 meter katrore, i cili ndodhet ne objektin godine banimi 12 kateshe, me nje kat parkim nentoke, ne xxxxx), i ndertuar mbi bazen e lejes se ndertimit nr. 3.87, date 07.06.2010 te KRRT-se prane Bashkise Vlore, te ndertuar nga subjekti “xxxxx” sh.p.k, apartament i cili eshte blere nga shtetasja xxx permes kontrates se shitblerjes se sendit te ardhshem nrxxxxxxx. Duke qene se keto pasuri perbejne produkte te vepres penale, me vendimin gjyqesor nr. xxxxxx te Gjukates se Rrethit Gjyqesor Vlore eshte vendosur masa e sigurimit pasuror e sekuestros preventive. Gjukata gjithashtu konstaton se provohet ne kete gjykim, me provat e mesiperme se e pandehura xxxxx, ka ushtruar aktivitetin kriminal te shfrytezimit te prostitucionit ne xxxxx dhe nga shfrytezimi i ketij aktiviteti kriminal rezulton se e pandehura ka perfituar te pakten shumen prej 487.899 euro.

Po keshtu, nepermjet provave te mesiperme rezulton se nje pjese te ketyre parave te perfituara nga aktiviteti kriminal jane investuar ne veprimtari ekonomike ne territorin e Republikes se Shqiperise, duke blere tre apartamentet e mesiperme.

Gjykata konstaton se nga keto prova provohet se e pandehura xxxxxx, ka kryer elementet e vepres penale "Pastrimi i produkteve te vepres penale ose veprimtarise kriminale", parashikuar nga neni 287/1 germa "d"te Kodit Penal.

Kjo e pandehur, ka investuar ne veprimtari ekonomike ne territorin e Republikes se Shqiperise, shumen e parave te perfituara nga aktiviteti kriminal ne fushen e shfrytezimit te prostitucionit ne xxx, ku nga kjo veprimtari kriminale ka perfituar te pakten shumen prej 487 899 Euro. Pra, del qarte se nga kjo shume parash e perfituar nga ushtrimi i aktivitetit kriminal eshte perfituar nje apartament banimi me numer pasurie 1xxxxx, me siperfaqe 112 meter katrore, nje apartamenti me nr. xxxxx, ne katin e shtate banimi, me siperfaqe 86.2 meter katrore, si dhe apartamenti me nrxxxxx ne katin e shtate banimi, me siperfaqe 70.97 meter katrore.

Objekt i kimit jane marredheniet juridike te vendosura me ligj per te siguruar interesat shteterore nga pastrimi i produkteve te vepres penale ne forma te ndryshme, te mbrojtura posaçerisht nga legjislacionin penal nga veprimet ose mosveprimet kriminale.

Nga ana objektive e pandehura e ka kryer kete veper me veprime aktive ne formen e perdorimit te pasurise kur dihej qe eshte produkt i vepres penale.

E pandehura eshte subjekt i vepres penale pasi ka mbushur moshen per pergjegjesi penale dhe rezultin te jete e pergjegjshme.

Nga ana subjektive vepra penale eshte kryer me dashja te drejtperdrejte dhe qellim fitimin.

Neni 287/d i Kodit te Procedures Penale parashikon se:

*"Pastrimi i produkteve te vepres penale ose veprimtarise kriminale, nepermjet:*

a).....

b).....

c).....

ç).....

*d)investimit ne veprimtari ekonomike ose financiare te parave a sendeve, duke ditur se jane produkte te vepres penale ose veprimtarise kriminale denohet me burgim nga pese vjet gjer ne dhjete vjet burgim.*

Gjykata bazuar ne nenin 47 te Kodit Penal, çmon se ekziston nje rrezikshmeri shoqerore te larte te vepres penale te kryer nga e pandehura dhe po keshtu, lidhur me sanksionin qe parashikon kjo veper penale nga 5 deri ne 10 vjet burgim tregon per nje veper qe ka nje rrezikshmeri shoqerore jo te paket. Gjithashtu, pasojat e ardhura nga kryerja e vepres penale, qe konsistojne ne investime ne blerjen e tre apartamenteve banimi ne qytetin e Vlores, tregon qe kjo e pandehur paraqet rrezikshmeri shoqerore jo te ulet. Po keshtu, e pandehura nuk ka pranuar kryerjen e vepres penale. Se fundi, kjo e pandehur rezulton te jete e padenuar me pare dhe kjo do te mbahet parasush edhe nga gjykata.

Gjykata çmon se per kete te pandehur lloji dhe masa e denimit per vepren penale te jete me burgim ne masen minimale prej 5 vjete burgim.

Gjithashtu gjykata çmon se duke qene se nga kryerja e vepres penale jane perfituar produkte te vepres penale, çmojme se bashke me denimin kryesor duhet te jepet edhe denimi plotesues i konfiskimit te mjeteve te kryerjes se vepres penale dhe produkteve te vepres penale, parashikuar nga neni 36 i Kodit Penal. Konkretisht duhet te vendoset konfiskimi i produkteve te vepres penale per te cilat me vendimin nr. 751, date 06.10.2017 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore eshte vendosur masa e sigurimit pasuror e sekuestros preventive.

### **PER KETO ARSYE**

Gjykata, bazuar ne nenet 47, 48, 287/1 germa "d"e Kodit Penal dhe 190/1/ç, 383, , te Procedure Penale,

### **V E N D O S I**

1. Deklarimin fajtor te te pandehures xxxx, per kryerjen e vepres penale "Pastrimi i produkteve te vepres penale ose veprimtarise kriminale", te parashikuar nga neni 287/1 germa "d" te Kodit Penal dhe denimin e saj me 5 (pese) vite burgim.

2. Vuajtja e denimit per te pandehuren Xnis nga dita e ekzekutimit dhe te kryhet ne nje burg te sigurise se zakonshme.

3. Ne baze te neneve 190.1 germa "a" te K.Pr. Penale dhe nenit 36.b te Kodit Penal, te konfiskohen dhe te kalojne ne favor te shtetit, produktet e vepres penale mbi te cilat me vendimin gjyqesore nr. 751, date 06.10.2017 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Vlore eshte vendosur masa e sigurimit pasuror e sekuestros preventive, e konkretisht te:

- Apartament banimi me numer pasurie xxxxx, me siperfaqe 112 meter katro eshte regjistruar ne regjistrin hipotekor nrxxxxx, apartament i blere nga shtetasja Xpermes kontrates se shitjes xxxxx

- Apartamenti nr. xxxx, ne katin e shtate banimi, me siperfaqe 86.2 meter katrore, i cili ndo objektin godine banimi 12 kateshe, me nje kat parkim nentoke, ne lagjen "xxxxx, i ndertuar mbi bazen e lejes se ndertimit nr. 3.87, date 07.06.2010 te KRRT-se prane Bashkise Vlore, te ndertuar nga subjekti xxxxx" sh.p.k, apartament i cili eshte blere nga shtetasja xxxx permes kontrates se shitblerjes se sendit te ardhshem nr. xxxx, date 10.06.2015.

- Apartamenti nr. xxxxx ne katin e shtate banimi, me siperfaqe 70.97 meter katrore, i cili ndo objektin godine banimi 12 kateshe, me nje kat parkim nentoke, ne lagjen "xxxxxxxxt), i ndertuar mbi bazen e lejes se ndertimit nr. xxxxxxxxxxxxxxxx, te ndertuar nga subjekti "xxxxxxxxxxx" sh.p.k, apartament i cili eshte blere nga shtetasja xxxx permes kontrates se shitblerjes se sendit te ardhshem nr. xxxxxxxxxxxx.

4. Shpenzimet procedurale i ngarkohen te pandehures xxxxxxxxxxxxxxxx.

5. Kunder ketij vendimi lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit Vlore brenda 15 diteve nga e nesermja e shpalljes.

U shpall ne Vlore, sot me date 11.06.2018

**SEKRETARE**

**GJYQTAR**

**Lefteri Spahaj**

a

**Për këto arsye**

Baza Ligjore:xxxxxxxxxxxxxxxx

**VENDOSI:**

Vendosi:

xxxxxxxxxxxxxxxx

**SHPENZIMET GJYQESORE**

<b>Kërkesëpadia</b>	0
<b>Taksa Gjyqësore</b>	0
<b>Noterizime</b>	0
<b>Njoftime</b>	0
<b>Akt ekspertimi</b>	0

**Avokat**

0

**Gjithsej**

0

**GJYQTAR:**

**Vjola Canaj**